



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA MEKANIKE BUJQESORE "HASAN D GINA" LUSHNJE

Nr. 547 prot.

Lushnje më 16/10/2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Përkrijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, dt.27.05.2021, i ndryshuar "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Mekanike Bujqesore "Hasan D Gina" ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin

- Nendrejtor të kultures profesionale ( me kohe te plote)

**1. Kriteria të përgjithshme dhe kriteria të posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- të demonstrojë aftësi drejtuese të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master shkencor” (ose të barasvlershme) në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;
- c) të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues publik të AFP-së;
- d) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit.
- e) Të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale profesionale të njërit prej drejtimeve mësimore të ofruesit të AFP-së.

## 2. Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 26.10.2023

DREJTOR I SHKOLLËS

ARDJAN PRIFTI

